



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

RR E G U L L O R E
P Ë R
NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE

Klinë, qershor 2015

Në bazë të nenit 11 si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 shkronja (c), të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale („Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,, nr. 28/2008), neni 36 të Rregullorës Finaciare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parave Publike, të dt. 23.05.2013, pastaj në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MEF-it nr. 2005/08 për Klasifikimin Ekonomik të Shpenzimeve, si dhe në bazë të nenit 10 parag. 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, po edhe pas Takimit më Publikun të mbajtur më dt.15.06.2015, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vetë të rregullt të VI-ën më radhë për vitin 2015, të mbajtur më dt. 19.06.2015, e shpall të miratuar:

R R E G U L L O R E N P Ë R N D A R J E N E S U B V E N C I O N E V E D H E T R A N S F E R E V E

I. D I S P O Z I T A T E P Ë R G J I T H Ë S H M E

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, procedurat dhe mundësit që komuna nga mjetet e veta të fondit buxhetor komunal nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të ndaj mjete financiare si ndihma momentale personave juridik (Institucioneve jofitimprurëse) dhe personave fizik.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të kategorisë së subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual, Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, e në pajtim me këtë rregullore ndan mjete financiare buxhetore si ndihmë momentale financiare, personave juridik (Institucioneve jofitimprurëse) dhe personave fizik, krejt këtë sipas mundësive buxhetore dhe procedurës, kriterëve dhe lëmive të përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 2

Përkufizimet dhe shkurtesat

1. Sipas kësaj rregullorje përcaktohen përkufizimet dhe nocionet juridike si dhe shkurtesat që përdorën në këtë rregullore ose edhe jashtë saj më qëllim që të bëhet sqarimi dhe zbatimi sa më i drejt i tyre, dhe zbatimi sa më i drejtë i kësaj rregullorje, si në vijim:

1.1 Subvencione dhe transferet- përfshijnë të gjitha ndihmat momentale të njëhershme dhe të njëanshme në para të gatshme e cila iu transferohet-ndahet personave juridik (Institucioneve jofitimprurëse) dhe personave fizik më nevojë, krejt kjo përmesë transferit në

llogarit bankare të rregullta të atyre subjekteve dhe personave sipas procedurës dhe rregullave të përcaktuara në ligj dhe ketë rregullore.

1.2 Parat Publike- ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Ligjit për Menaxhmin e Fiancave Publike dhe Përgjegjësit.

1.3 Obligim- do të thotë marrëveshje ligjore siq është kontrata apo urdhër blerja në të cilën ka hyrë Organizata buxhetore dhe e cila kërkon nga OB që të bëj shpenzim.

1.4 Llogari zyrtare bankare- do të thotë një llogari ose nenë llogari e krijuar nga drejtori i përgjithëshem i thesarit, më qellim të pranimit, trajtimit e dispozitave dhe shpenzimit e parave publike.

1.5 Zotimet- nënkupton shpenzimet e parashikuara për të cilat është dorzuar Urdhresa e Zotimit në përputhje më Rregullat finaciare të Thesarit dhe që është e regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Informatave Financiare, pavarësisht se a i nënshtrohet detyrimit apo jo.

1.6 Zyrtari Kryesor Financiar- nënkupton personin mbrenda organizatës buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike i cili është i punësuar sipas nenit 12 të LMFP-it.

1.7 Zyrtari Çertifikues- nënkupton individin në një organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive ose ndërmarrje publike i cili është i punësuar sipas nenit 14 të LMFP-it.

1.8 Zyrtarët financiar- nënkupton dhe përfshinë Zyrtarin kryesor administrativ, Zyrtarin kryesor financiar, Zyrtarin e prokurimit dhe Zyrtarin e çertifikimit

1.9 Shpenzimet- do të thotë pagesat e parave nga Fondi i Konsoliduar i Republikës së Kosovës.

1.10 Udhëheqësi i Organizatës Buxhetore- nënkupton individin i cili mban pozitën më të lartë në një Organizatë buxhetore.

1.11 Detyrim kontigjent- do të thotë një detyrim i cili matrializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmën, krejt kjo sipas nenit 1 dhe sqarimeve tjera nga LMFP-së.

2. Sqarimi i shkurtesave të përdorura në ketë rregullore dhe jashtë saj, janë siq vijon:

2.1 OJQ- Organizatë Jo qeveritare-jo fitimprurëse.

2.2 SIMFK- Sistemi informativ i menaxhimit financiar në Kosovë.

2.3 PIP- Programi i investimeve Publike.

2.4 NJQH- Njësia Qëndrore Harmonizuese.

2.5 UZP- Formulari i urdhërit për zotim e pagesë.

2.6 ZKF- Zyrtari Kryesor Financiar.

2.7 ZKA- Zyrtari Kryesor Administrativ.

2.8 MFK- Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.

Neni 3

Subvencionet apo ndihma e njëanshme momentale për personat juridik (Institucionet jofitimprurëse)

1. Kërkesat e personave juridik-institucioneve jofitimprurëse për subvencione duhet t'i drejtohen Kryetarit të Komunës përmes Zyrës së pranimit dhe protokollimit. Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacionin mbështetës si:

- 1.1 certifikatën e regjistrimit,
- 1.2 arsyetimi i kërkesës me projekt të qartë dhe bindës,
- 1.3 numri i llogarisë bankare të personit juridik jofitimprurës, si dhe
- 1.4 informatën vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar si dhe informacionin lidhur me qarkullimin eventual financiar.

2. Kërkesat e pa kompletuara si dhe ato që nuk i plotësojnë kriteret do të refuzohen dhe nuk do të procedohen më tutje, nga aprovuesi i shpenzimeve për subvencione dhe transfere.

Neni 4.

Kryetari i komunës pas pranimit të kërkesës së kompletuar nga Zyra e Pranimit, e autorizon drejtorinë përkatëse, të jep mendim profesional për përfituesit në afat prej 15 ditësh. Pas shqyrtimit të kërkesës, drejtoria përkatëse i propozon Kryetarit të Komunës për miratim kërkesën e justifikuar dhe të dëshmuar-argumentuar me dokumentacionin përcjellës.

Neni 5.

1. Kryetari i Komunës, merr vendim lidhur me kërkesën e personit juridik, deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik deri në shumën prej 2,000.00 €, përveç në raste kur më këtë rregullore parashifet ndryshe.

3. Pavarësisht propozimit të Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, Kryetari i Komunës mban të drejtën të subvencionoj-financoj projektin pjesërisht apo plotësisht për persona juridik dhe fizikë, në bazë të arsyeshmëris dhe provave të prezantuara.

4. Nëse ndihmat financiare kanë të bëjnë me shumë më të madhe, se që është përcaktuar në paragrafin 2, të këtij neni dhe në paragrafin 1, të nenit 17 të kësaj rregulloreje, për të njëjtën vendosë Komiteti për Politikë dhe Financa me vendim paraprak mbi delegimin e kësaj kompetence, kurse Kuvendit i paraqitet raport për çdo gjashtë (6) muaj.

5. Përjashtim nga parag. 2 dhe 4 i këtij neni bëhet në rastet kur subvencionohen projektet që parashifën më planet e punës së institucioneve nënë autoritetin e Komunës, rastet kur projektet realizohen nga institucionet komunale dhe nënë patronatin e tyre për shenimin e datave të rëndësishme Shtetore dhe Komunale, si dhe projektet që realizohen më bashkëfinancim.

Subvencionimi dhe përkrahja e projekteve dhe aktiviteteve sipas lëmijve

Neni 6

1. Projektet në lëmin e arsimit

1. Përkrahja financiare në lëmin e arsimit mund të bëhet për manifestimet e ndryshme dhe organizimin e aktiviteteve shkollore të të gjitha niveleve shkollore dhe arsimit që ndërlidhën më karakterin edukativo arsimor dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit.

2. Përkrahje të qëndrueshme financiare mund të bëhen edhe për përfitimin e bursave për studentë të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës dhe bursa për nxënës të shkollave të mesme publike, dhe atë për fëmijë-studentet e familjeve të Deshmorve dhe rastet sociale, krejt kjo sipas mundsive buxhetore dhe Konkursit dhe Ftesës përkatëse publike që e shpall Drejtoria e Arsimit në Klinë, më kushtet dhe kriteret adekuate të aplikimit.

3. Përkrahje mund të ketë edhe lidhur më pagesat e transportit të nxënësve nga shtëpia në shkollë sipas distancës së lejuar ligjore për një drejtim, vetëm për nxënësit e shkollave të obligueshme publike.

Neni 7

2. Projektet në lëmin e kulturës

1. Përkrahja financiare e projekteve nga lëmija e kulturës mund të bëhet dhe përfshinë: Promovimin e festivaleve, koncerteve, orve letrare, ekspozitave të arteve pamore, veprimtarit teatral, botimi dhe promovimi i librave përkatëse, organizimet festive, trashigimit kulturor, akademit përkujtimore si dhe aktivitetet tjera që organizohen nënë përkujdesjen e Komunës së Klinës dhe organeve të saja.

2. Lëmija e trashëgimisë kulturore përfshinë aktivitetet si: Hulumtimet e trashëgimisë, gërmimet arkeologjike, ruajtja, restaurimi dhe konservimi i vlerave të trashëgimisë mbështetet sipas rëndësisë së objekteve që duhet hulumtuar dhe ruajtur dhe atë në faza adekuate.

Neni 8

1. Projektet nga fusha e manifestimeve kulturore, shënimin e datave historike, akademitë përkujtimore, çmimeve, titujve të nderit, medaljeve dhe të gjitha shperblimet dhe aktivitetet tjera që organizohen nga Komuna dhe institucionet e saja janë si më poshtë :

1.1 Organizimi festiv për manifestimin e “17 shkurtit” Dita e shpalljes se Pavarsisë se Shtetit të Kosovës,

1.2 Organizimi festiv për “18 Qershorin” Dita e Çlirimit të Klinës,

1.3 Organizimi festiv për Festivalin Tradicional muzikor “I Këndojm Lirisë,,

1.4 Organizimi i Akademisë përkujtimore të 4 prillit Ditës se të Zhdukurve të Komunës se Klinës,

1.5 Organizimi i Akademisë përkujtimore për „Ismet Raci,,

1.6 Organizimi i Orës letrare „Tahir Desku,,

1.7 Organizimi i Festës se 28 Nëntorit,,

1.8 Organizimi i Festës se Vitit të Ri,

1.9 Përkrahja e Asambles komunale të fëmijve,

1.10 Përkrahja e aktiviteteve të interesit publik të fëmrave përkatësisht organizatave publike të grave, nese nuk ka donator, si dhe

1.11 Organizimi i manifestimeve të ndryshme kulturoro-artistike dhe ndarja e çmimeve, titujve të nderit si dhe të gjitha shperblimeve tjera sipas rregullorës se veqantë qe rregullon dhe përcakton ato manifestime dhe shperblime.

2. Manifestimi i këtyre aktiviteteve është i bazuar, në:

2.1 Projektin e manifestimit,

2.2 Rëndësin dhe traditën e manifestimit,

2.3 Nivelin e organizimit, interesin publik të tij, kohëzgjatjën, numrin e anëtarve të manifestimit si dhe çmimin e festivalit tradicional.

Neni 9

3. Projektet dhe përkrahja në lëmin e rinisë

1. Mund të bëhet edhe përkrahja e projekteve në fushën e rinisë të cilat projekte janë të arsyetuara dhe të bazuara në Ligjin për Pjesëmarrje dhe Fuqizim të Rinisë, e të cilat projekte ndërlihdhën më aktivitetet e interesit publik qe kan të bejnë më fuqizimin e rinisë dhe organeve dhe aktiviteteve të saja.

2. Subjektet rinore të cilat kan të drejtë përfitimi nga subvencionet prej Sektorit të Rinisë janë:

2.1 Qendra Rinore,

2.2 Këshilli i Veprimit Rinor Lokal-KVRL,

2.3 Subjektet rinore qe promovojn punën vullnetare me të rinj, si dhe

2.4 Të gjitha organizatat rinore nga të cilat përfitojn të rinjtë dhe të cilat kan për qellim implementimin e politikave rinore dhe strategjisë komunale për rinin. Në këtë grup të organizatave hyjnë ato të cilat realizojn programe kundër dukurive negative dhe të cilat ndihmojn të rinjtë për punësim dhe edukim jo-formal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim).

3. Kërkesës për përkrahje të aktiviteteve rinore i bashkangjitet i terë dokumentacioni i cili arsyeton aktivitetin, pastaj dergohet edhe projekti adekuat i cili përfshinë rëndsin e aktivitetit dhe qellimin, niveli i organizimit, kohëzgjatja si dhe numri i anëtarve pjesëmarrës në projekt.

Neni 10

4. Përkrahja e projekteve në lëmin dhe aktivitetet sportive

1. Projektet qe mund të përkrahën në fushën e sportit përfshijnë:

1.1 Masivizimi i sportit për të rinj;

1.2 Përkrahje të qëndrueshme financiare për sportistët kulmor dhe klubet kualitative, të cilat mund të arrijnë rezultate të mira sportive;

1.3 Avancimin dhe përkrahjën financiare të organizimit në klubet sportive;

1.4 Përkrahja dhe mbeshtetja financiare sipas mundsive buxhetore komunale ndaj Klubit futbollistik „Dugajini,, në Klinë.

Neni 11

5. Subvencionimi i projekteve sipas kërkesave të OJQ-ve dhe kriteret e vlerësimit të tyre

1. Sipas kërkesave të OJQ-ve mbrënda mundsive buxhetore mund të mbeshtetën financiarisht këto aktivitete:

1.1 Promovimi i vullnetarizmit (aktivitetet për shërbime të arsimit , avokim, kampanjë, menaxhment, aktivitete komunitare dhe ambiente etj.);

1.2 Integrimi i grupeve të marginalizuara;

1.3 Fuqizimi i organizatave rinore (seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjve);

1.4 Edukimi joformal (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim);

1.5 Punësimi sezonal i të rinjve për interesa publike, si dhe

1.6 Infrastruktura për rini, për moshën e mesme, dhe moshën e shtyer.

Neni 12

1. Kërkesat që rrjedhin nga neni 11 i kësaj rregullorje duhet të kenë provat mbështetëse si në vijim:

- 1.1 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
- 1.2 Certifikata e Regjistrimit të OJQ-së ;
- 1.3 Fotokopja e kartelës së xhirollogarisë dhe letërnjoftimin e bartësit të kartelës;
- 1.4 Shënimet e personit kontaktues, si dhe
- 1.5 Dokumentacionin tjetër të nevojshëm që e kërkon komisioni vlerësues apo Kryetari i Komunës.

Neni 13

6. Projektet nga fusha e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore

1. Projektet të cilat mund të përkrahën sipas kësaj kategorije janë projektet të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në të gjitha fushat jetësore, si: (barazia gjinore, integritet socio-kulturor dhe mundësitë e barabarta, parandalimit të dhunës në familje, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, personat hendikos, si dhe të drejtat e kategorive të tjera të ngjashme, krejt kjo sipas mundësive buxhetore komunale.
2. Në mënyr analoge si në lëmit e më sipërme edhe kategorit apo subjektet që përfaqësojnë ato si nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të paraqesin dokumentacionin adekuat për realizimin e ndihmës dhe mbështetjes financiare.

Neni 14

7. Projektet nga lëmija e bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Projektet nga lëmi i bujqësisë mund të subvencionohen për aktivitetet përkatëse dhe atë si bashkfinancim apo financim i pjesrishëm sipas mundësive buxhetore komunale.
2. Subvencionimi i projekteve bëhet nga lëmi i: pemëtaris, perimtarisë (serat e ndryshme), bletarisë (kosheret dhe matrialet tjera të ngjashme), pastaj në degën e shpeztarisë, si dhe ndihma shoqatave të ndryshme të fermerëve, krejt këto si bashkfinancim më parashtruesin e kërkesës pra si financim i pjesrishëm nga ana e komunës, po ashtu mund të përkrahën edhe projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin rural pra fshatrave në viset rurale të Komunës së Klinës.
3. Më rastin e shqyrtimit të kërkesave nga lëmija e bujqësisë dhe zhvillimit rural, përparësi do të kenë projektet të cilat do të realizohen më bashkfinancim të mjeteve, ndërsa procesi i përzgjedhjes së përfituesve do të bëhet nga komisioni përkatës i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, mbi bazë të Ftesës publike për aplikim.

Neni 15

8. Projektet në lëmin e mjedisit

1. Në lëmin e mjedisit mund të ndihmohët shënimi i Ditës se Tokës, Ditës se Mjedisit, Java e Ekologjike (vetëm sa i përket furnizimit më matriale dhe paisje për shënimin e këtyre festave mjedisore).
2. Komuna mund të ndihmoj edhe në projektet që ndërlidhën me infrastrukturën rrugore, infrastrukturën e kanalizimit dhe ujrave të zeza, krejt këto në bashfinancim dhe participim më komunitetin dhe sipas mundsive buxhetore komunale.

Neni 16

9. Subvencionet në lëmin e shendetësisë si ndihmë momentale për individë dhe familjet në nevojë (etnitetet jo publike)

Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara ndanë ndihmë momentale financiare nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës, për raste urgjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, mbështetja financiare për varrimin e më të afërmeve të familjeve në nevojë dhe në varfëri të skajshme, për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm, për familjet si raste sociale, si dhe për familjet e Deshmorve të luftës.

Neni 17

1. Kryetari i Komunës, lidhur më kategorit nga neni 16 i kësaj rregullorje lejon ndarjen e ndihmës financiare-subvencioneve për persona dhe familjet në nevojë si ndihmë materiale për përkujdesje sociale dhe shëndetësore, dhe atë shumën e cila mund të jetë deri në 500,00€.
2. Ndhima materiale e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, nënkupton sigurimin e të hollave, gjërave ushqimore apo kompensimin e trajtimit të domosdoshëm mjekësor për një individ apo familje në nevojë.
3. Për çdo shumë më të lartë nga parag. 1 i këtij neni vendos Kuvendi i Komunës se Klinës.

Neni 18

1. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmës materiale;

- 1.1. Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësor të specialistit;
- 1.2. Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
- 1.3. Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera,
- 1.4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme elementare natyrore, si dhe
- 1.5 Dokumentet tjera të cilat tregohën të nevojshme për mbështetje të kërkesës.

Neni 19

Kërkesë për ndihmë momentale mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet në nevojë që janë banorë të përhershëm të Komunës së Klinës.

Neni 20

Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë momentale për individ dhe familje në nevojë

1. Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës në përbërje të zyrtarëve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është kompetent për shqyrtim të kërkesës eventuale për ndihmë momentale individit apo familjes dhe në afat prej 15 ditësh të bënë propozimin e mundshëm për ndihmë momentale.
2. Kërkesat e pakompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj më tutje.
3. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të Komisionit.
4. Ndarja e subvencioneve në lëmin e shëndetësisë do të aplikohet deri në miratimin dhe zbatimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore.

Neni 21

1. Shuma e ndihmës momentale për personat fizikë dhe familjar propozohet nga Komisioni deri në limitin e përcaktuar në nenin 17 paragrafi 1 të kësaj rregullorje.
2. Personi dhe familja e caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vit me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 22

Komisioni, listën e specifikuar të propozuar për ndihmë momentale ja dorëzon Kryetarit të Komunës për miratim, i cili ka mundësi ta ndryshojë atë, duke dhënë arsyetimin për ndryshimin e vlerave përkatëse të ndihmës.

Neni 23

II.- DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Në raste konflikti të dispozitave të kësaj rregullore dhe dispozitave ligjore përkatëse apo edhe zbrastësires tjetër juridike do të zbatohën drejt për se drejti dispozitat ligjore si dhe aktet tjera rregulloret përkatëse të ministrive kompetente.

Neni 24

Për zbatimin-implementimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në Klinë.

Neni 25

Kjo rregullore mundë të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjese për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqën zyrtare të komunës, kjo në kuptim të nenit 18 i Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.

Nr. 06-4043 /2015
Klinë, më dt. 29.06 2015.

KUVENDI I KOMUNËS NË KLINË

Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

